



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 05.11/2012
Nr. 0204 -1153

PËR: Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Vesel Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË
KOMUNËS SË SUHAREKËS ,01- Nr. 16.6866; 01 Nr.166868; 01 - Nr.16.6867.

Pranuar me datën: 29/10/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeveritarisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve të miratuara me datë 24.10.2012 **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara si vijon, kanë efekt të plotë juridik;

- Vendim 01 - Nr. 16.6866 për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit "Ukë Bytuçi";
- Vendim 01 - 16.6868 për plotësimin - ndryshimin të këshillit të ekspertëve për planinin zhvillimor komunal, planinin zhvillimor urban dhe planet rregulluese urbane;
- Vendim 01 - Nr. 16.6867 për miratimin e marrëveshtjes për bashkëpunim ndërkombëtar (binjazim) në mesë Bashksisë së Sarandës të Republikës së Shqipërisë dhe komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 05.11/2012
Br.0204 -1153

Za: Blerim Kuçi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedvajući Skupštine Opštine Suva Reka

Predmet: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKA OPŠTINE SUVA REKA ,01- Br. 16.6866; 01
Br.166868; 01 - Br.16.6867.

Priljeno dana: 29/10/2012

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja usvojenih Odluka, dana 24.10.2012 **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i procenjuje da su ista u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravna Akta koja su navedena u nastavku, imaju puni pravni efekat ;


- Odluka 01 - br. 16.6866 o usvjanju predloga komisije za dodelu nagrade "Ukë Bytuçi";
- Odluka 01 - br.16.6868 za dopunu - izmenu saveta eksperata za opštinski razvojni urbani razvojni plan, i regulativne urbane planove;

Odluka 01 - br. 16.6867 o usvajanju sporazuma za medjunarodnu saradnju (bratimljenje) izmedju Opštine Saranda Republika Albanija i Opštine Suva Reka Republika Kosovo , i to u sklopu svojih sopstvenih nadležnosti.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Minista MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
 REPUBLIKA KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË

01-Nr-

DËRGUAR - DOSTAVLJENO - SENT

Nr. Br. No.	Data Datum	Selja Segršte Hq	Adresa Adresa
01-16 5895	29.10 2012	SUHAREKË	PRISHTINË

HYRËSE-ULAZNA-INGOINGO
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data Datum: 29.10.2012
 Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	2024-1153	4	

Për: **Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë
 - Departamentit Ligjore**

Nga: **Avni Bytyçi – Shefi i Shërbimit të Kuvendit në Suharekë**

Lënda: **Akt përcjellës**

Data: **29 tetor 2012**

I/c nderuar,

Me anë të kësaj shkrese Ju përcjellim Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, Nga një kopje të vendimeve ju dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008).

Lista e akteve të cekura më lartë:

Nr.	Emri i Rregullores apo i Vendimit	Data e Miratimit
1.	Vendim për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit "Ukë Bytyçi"	24.10.2012
2.	Vendim mbi plotësim- ndryshim të kështillit të eksperteve për planin zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe planet rregulluese urbane	24.10.2012
3.	Vendim mbi miratimin e marrëveshja për bashkëpunim ndër-kombëtar	24.10.2012


Andaj kërkojmë nga Ju që konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, të bëni shqyrtimin e ligjshmërisë dhe në afat sa më të shkurtë të na ktheni përgjigje me shkrim lidhur me ligjshmërinë e këtyre vendimeve.

Me respekt,



Shefi i Shërbimit të Kuvendit
 Avni Bytyçi

Kopje:
 MAP/osc
 Arkiva



Në bazë të nenit 12 dhe 40, paragrafi 2, pika (h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, nenit 11, 28 paragrafi 2, pika (h), dhe 29, paragrafi 2, pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat e ndarjes së çmimit “Ukë Bytyçi” 01-Nr-16-5820, të datës 29.09.2011, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 24.10.2012, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit
“Ukë Bytyçi”

Neni 1.

Çmimi “Ukë Bytyçi” për Udhëheqje të mirë i ndahet z. Beqir Seferaj lindur 03.06.1956, në fshatin Gjinoc Komuna e Suharekës, Drejtor i firmës SHPK “I.Seferi” me seli në fshatin Gjinoc, Komuna e Suharekës.

Neni 2.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 8, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNESË NE SUHAREKË

01-Nr- 16-6866
Më datë 24.10.2012



Kryesuesi i Kuvendit

V. Maliqaj
Vesel Maliqaj



Duke u bazuar në nenin 12, 14 dhe 17, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, nenit 15, 27, 28 dhe 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.08, nenin 6, të Ligjit për Planifikim hapësinor, Nr-2003/14, udhëzuesit për formimin e Këshillit të ekspertëve të planifikimit, Nr-04/3313/1, të datës 04.11.2004, Kuvendi i Komunës në Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2012 merr këtë:

V E N D I M B I P L O T S I M - N D R Y S H I M
TE KËSHILLIT TË EKSPERTEVE PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL, PLANIN
ZHVILLIMOR URBAN DHE PLANET RREGULLUESE URBANE

Neni 1.

Me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale në procesin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban si dhe në procesin e hartimit dhe zbatimit të Planeve Rregulluese Urbane, Kuvendi i Komunës me këtë vendim bënë plotësim-ndryshimin e Këshillit të ekspertëve të planifikimit si organ këshillëdhënës dhe Grupin për mbikëqyrje dhe koordinim.

a) Këshilli i ekspertëve të planifikimit :

1. Muhamet Shala..... kryesues
2. Mehmet Gashizëvendës kryesuese
3. Shqiponja Berisha.....anëtare
4. Refki Gega.....anëtar
5. Ruzhdi Kuçi.....anëtar
6. Florim Kryeziu.....anëtar
7. Izet Buzhala.....anëtar

Neni 2.

Këshilli i ekspertëve ka për detyrë të:

- a. jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit (Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planeve Rregulluese Urbane) të cilat miratohen nga Kuvendi Komunal.
- b. Shqyrtojnë dhe propozojnë zgjidhje përkatëse në rastet e jo harmonizimit të strategjive zhvillimore
- c. Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë këto dokumente
- d. Kryen edhe detyra të tjera të cilat dalin nga fushat e planifikimit
- e. Punon ngushtë dhe në vazhdimësi me grupin e planerëve
- f. Për punët administrative – teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e këshillit të ekspertëve përgjegjës është Kuvendi Komunal .

Neni 3.

Këshilli për punën e vet ka për detyrë që rregullisht ta informoj Kuvendin Komunal në Suharekë

Neni 4.

Këshilli përcakton vetë rregullat e punës së tij.

Neni 5.

Anëtarët e këshillit për punën që dot kryejnë do te kompensohen me nga 50€ për çdo takim.

(b) Grupi për bashkëpunim dhe koordinim:

1. Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikim dhe Mjedisit -anëtar
2. Drejtori i Drejtorisë për Administratës së Përgjithshme -anëtar
3. Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet -anëtar
4. Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë -anëtar
5. Drejtori i Drejtorisë së Mërgatës - anëtar
6. Drejtori i Drejtorisë Bujqësisë dhe i pylltarisë -anëtar
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë -anëtar
8. Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale -anëtarë
9. Drejtori i Drejtorisë për Rini dhe sport -anëtar
10. Drejtori i Drejtorisë për shërbime pronëso-ro-juridike dhe kadastër-anëtar
11. Përfaqësuesi i zyrës regjionale për planifikim hapësinor në Prizren -anëtar
12. Përfaqësuesi i LMT-së -anëtarë
13. Përfaqësuesi i minoriteteve -anëtarë
14. Përfaqësuesi i LDK-ës -anëtar
15. Përfaqësuesi i PDK-së -anëtar
16. Përfaqësuesi i AAK-së -anëtar
17. Përfaqësuesi i PS-së ---anëtar
18. Përfaqësuesi i AKR-së -anëtar
19. Përfaqësuesi i PD-së -anëtar
20. Përfaqësuesi i VV -së -anëtar

Neni 6.


Ky vendim zëvendëson vendimin 01-Nr-16-567 të datës 01.02.2012, për emërimin e këshillit të eksperteve për planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban për periudhën 2005-2015, sipas rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 7.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 8, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr- 16-6868
Më datë 24.10.2012



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj

Në bazë të neneve 12, 28 dhe 30, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, dhe konform nenit 4, nenit 5, dhe nenit 8 pika 2, të Ligjit për bashkëpunim ndër-komunal, Nr-04/L-010, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2011), Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 24.10.2012, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.

MIRATOHET, marrëveshja për bashkëpunim ndër-kombëtar, (binjakëzimit) në mesë Bashkisë së Sarandës të Republikës së Shqipërisë dhe Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake.

Neni 2.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është marrëveshja për bashkëpunim ndër-kombëtar, e nënshkruar nga dy Kryetaret, Kryetari i Bashkisë së Sarandës të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetari i Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës.

Neni 3.

Për zbatimin e kësaj marrëveshje do të kujdestë Kryetari i Komunës së Suharekës, në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive.

Neni 4.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 8, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008) dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S – S U H A R E K Ë



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj
Veseli Maliqaj

01-Nr- 16-6867
Më datë 24.10.2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKËS

MARRËVESHJE MIQËSIE DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET
BASHKISË SË SARANDËS-REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHE
KOMUNËS SË SUHAREKËS-REPUBLIKA E KOSOVËS

*Në frymën e respektit reciprok, ndërmjet shtetit Shqiptar dhe Kosovar,
sot Kryetari i Bashkisë së Sarandë dhe Kryetari i Komunës në Suharekë*

z. Stefan Çipa dhe z. Blerim Kuçi

Nënskruajnë nëpërmjet këtij akti zyrtar

BINJAKËZIMIN E SARANDËS DHE SUHAREKËS

*Mbështetur në miqësinë e përhershme, vëllazërinë, përparimin
dhe paqen midis shtetit Shqiptar dhe Kosovar.
Duke bashkuar forcat tona në një përpjekje të përbashkët bashkëpunimi
në fushën e kulturës, arsimit, sportit, ekologjisë, ekonomisë dhe turizmit
do të punojmë për zhvillimin e përparimin e shtetit tonë, unitetin,
demokracinë, barazinë dhe paqen në Evropë.*

Më 25 shtator 2012

Stefan ÇIPA

KRYETARI I BASHKISË

Blerim KUÇI

KRYETARI I KOMUNËS